

VENDIM
Nr. 34/2024

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 94/2017,
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT
TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONERËVE PUBLIKË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, neneve 18, pika 1, e 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 55 të rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionerëve Publikë,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1 e vendimit të Kuvendit nr. 94/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”, i ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 11.4.2024.

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOMISIONERËVE PUBLIKË

| FUNKSIONI ORGANIK | Klasifikimi i pagës | Numri |
|---|-------------------------------------|--------------|
| I. KOMISIONERI PUBLIK | | (4) |
| Komisionerë Publikë | G3* | 2 |
| Sekretarë | Sekretar në kabinetin e ministrit** | 2 |
| II. KANCELAR | I-1 | (1) |
| III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR | | (10) |
| Këshilltarë juristë | 80% e pagës G3* | 6 |
| Këshilltarë ekonomistë | 80% e pagës G3* | 4 |
| IV. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIK | | (7) |
| Drejtor | I-4 | 1 |
| Specialist sekretarie | IV-1 | 2 |
| Specialist Redaktor gjuhësor | IV-1 | 1 |
| Përkthyes | II -1 | 1 |
| Koordinator për Median dhe Marrëdhëniet me Jashtë | II-1 | 1 |
| Specialist Pritje me popullin | IV-1 | 1 |
| V. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE | | (8) |
| Drejtor | I-4 | 1 |
| Specialist Financë/Buxhet | IV-1 | 1 |
| Specialist i Burimeve Njerëzore | IV-1 | 1 |
| Specialist IT*** | IV-1 | 1 |
| Specialist Protokoll/Arkiv**** | IV-1 | 1 |
| Magaznier | VI | 1 |
| Punonjës pastrimi | II | 1 |
| Shofer/Korrier | V | 1 |
| Total | | 30 |

Shënim

* Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

** Kategoria e pagës për pozicionin e Sekretarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

*** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të Teknologjisë së Informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

**** Punonjësit në pozicionet Specialist Arkivi përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.

***** Përfutimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve.